

Studentët e Universitetit Mesdhetar trajnim pranë Institucionit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil

Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit me Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë, në ambientet e Institucionit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, u zhvillua një trajnim me studentë të këtij universiteti, me qëllim njohjen e tyre me legjislacionin e shërbimit civil dhe me rolin e Komisionerit në mbikëqyrjen e zbatimit të tij.



Në fjalën e saj, Komisionerja për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, znj. Leterije Lleshi (Luzi) theksoi rëndësinë e bashkëpunimit me institucionet akademike dhe të përfshirjes së studentëve në aktivitete që i njohin nga afër me funksionimin e administratës publike.

“Bashkëpunimi mes institucioneve publike dhe universiteteve është thelbësor për përgatitjen e profesionistëve të së nesërme dhe për forcimin e kulturës së shërbimit ndaj qytetarit. Administrata publike ka nevojë për të rinj të përgatitur, me integritet dhe me dëshirë për të kontribuar në këtë proces”-u shpreh Komisionerja.



Nga ana e saj, znj. Luljeta Kodra, zv. Dekane për Kërkimin Shkencor në Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Humane në Universitetin Mesdhetar, vlerësoi bashkëpunimin me institucionin e Komisionerit dhe përcolli interesin e studentëve për t'u angazhuar në programet e trajnimit që ofron institucioni.

Në përfundim të aktivitetit, studentëve iu shpërndanë certifikata pjesëmarrjeje, ndërsa u theksua rëndësia e vazhdimit të bashkëpunimit mes institucioneve publike dhe universiteteve për të nxitur njohjen dhe angazhimin e të rinjve në administratën publike dhe në shërbimin civil.

